



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 50, datë 27.1.2021

P Ë R

**PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN
E RIKONSTRUKSIONIT TË NJËSIVE INDIVIDUALE TË BANIMIT
DHE NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT),
NË BASHKITË RROGOZHINË, MIRDITË DHE KAMZË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", 25 e 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr.137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 180 890 000 (njëqind e tetëdhjetë milionë e tetëqind e nëntëdhjetë mijë) lekë, për financimin e rikonstruksionit të njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat), për ato individë të cilët përfitojnë nga grantet e rikonstruksionit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë si pasojë e fatkeqësisë natyrore dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, por kanë nevojë për punime rikonstruksioni ose riparime, në bashkitë Rrogozhinë, Mirditë dhe Kamzë, sipas detajimit të mëposhtëm:
 - a) Bashkisë Rrogozhinë i transferohet fondi në masën 61 270 000 (gjashtëdhjetë e një milionë e dyqind e shtatëdhjetë mijë) lekë;
 - b) Bashkisë Mirditë i transferohet fondi në masën 11 150 000 (njëmbëdhjetë milionë e njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë;
 - c) Bashkisë Kamzë i transferohet fondi në masën 108 470 000 (njëqind e tetë milionë e katërqind e shtatëdhjetë mijë) lekë.

2. Efekti financiar, sipas pikës 1, të këtij vendimi, të përballohet nga pjesa e financuar nga shpenzimet e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2021, dhe t'u kalojë bashkive Rrogozhinë, Mirditë dhe Kamzë në formën e transfertës së pakushtëzuar.
3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë Rrogozhinë, Mirditë dhe Kamzë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

**MINISTRI I SHETIT
PËR RINDËRTIMIN**

ARBEN AHMETAJ

NR.PROT.542/1
DATE 29.10.2021

MINISTRIT TË SHTETIT PËR RINDËRTIMIN
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE
EKONOMISË
BASHKIVE RROGOZHINË, MIRDITË,
KAMZË
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Engjëll Agaçi', is written over a circular official stamp. The stamp is light blue and contains the text 'REPUBLIKË E SHQIPËRISË' at the top and 'MINISTRI I MIRBETIMIT' at the bottom, with a central emblem.